REFORMA E PROGRAMIT TE MBROJTJES SOCIALE

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 (Plani i veprimit)

- Vizioni: *Ndërtimi i një sistemi mbrojtjeje sociale që të luftojë pabarazitë socio-ekonomike, parashikimi i një sistemi që ka politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe të riintegrimit social alternuar me skemat e punësimit.*

Objektivat e Strategjisë

- **Deri në vitin 2020, do të ndikohet në zbutjen dhe reduktimin e varfërisë esktreme nëpërmjet skemës së NE dhe programit të ri-integrimit social**

- **Deri në vitin 2020, cdo fëmijë, apo/dhe i rritur me aftësi të kufizuara do të ketë akses dhe përfitojë nga shërbimet e nevojshme sociale dhe të integruara nëpërmjet skemave të Programit të Mbrojtjes Sociale.**

- **Deri në vitin 2020, cdo fëmijë dhe familje shqiptare do të kenë akses të barabartë dhe përfitojnë nga një sistem funksional dhe përfshirës shërbimeve të përkujdesit shoqëror të bazuar në parimin e decentralizimit, deinstitucionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve sociale**

Decentralizimi

Në lidhje me procesin e Decentralizimit të shërbimeve shoqërore janë ndjekur me përparësi zhvillimet e fundit të Reformës Territoriale dhe procesit të Hartimit të Strategjisë Decentralizimit.

- Janë realizuar disa skenarë të decentralizimit të shërbimeve shoqërore dhe është disenjuar roli i të gjitha niveleve në nivel qëndror, rajonal dhe vendor.

- Eshtë hartuar paketa e shërbimeve bazë për pushtetin vendor, për strukturat e reja si dhe krijimin e profileve të punonjësve socialë.

- Është miratuar ligji "Për një shtesë në ligjin nr.10.171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar"ku janë përfshirë si profesionet e punonjësit social dhe psikologut. Paralelisht me këtë process **është miratuar Ligji nr. 163/2014 datë 4.12.2014 "Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë.**

- Është hartuar draft urdhri për psikologun në Republikën e Shqipërisë.

De-institucionalizimi

Konsolidimi i mëtejshëm i procesit të De -institucionalizimit.

Hartimi I Planit te Veprimit

1. Projekti "Shërbime sociale inovative për grupet në nevojë: standardet për decentralizimin"IADSA

Janë arritur rezultate pozitive në këto drejtime:

- **Qendra e Zhvillimit për PAK në Tiranë** - Përmirësimi i kushteve të jetesës nëpërmjet ndërhyrjeve në infrastrrukturë/ hapja e Qendrës Ditore për 20 fëmijë me AK.
- **Qendra e Fëmijëve në Shkodër** - Përmirësimi kushteve të jetesës nëpërmjet ndërhyrjeve në infrastrrukturë të realizuara krejtësisht, nëpërmjet ngritje dhe funksionimit së Qendrës Ditore për 10 fëmijët e komunitetit rom dhe fëmijët e rrugës.
- **Qendra e të Moshuarve në Shkodër** - permirësimin e kushteve të jetesës nëpërmjet ndërhyrjeve në infrastrukturë, dizenjimi I shërbimeve të vullnetarizmit dhe asistencës shtëpiake.

Transformimi i Shtëpisë Fëmijës "Zyber Hallulli"

- ***Qëllimi i këtij plani*** është të ofrojë një kornizë veprimi për procesin gradual dhe sistematik të reduktimit të numrit të fëmijëve pa kujdes prindëror që ndodhen në institucionin rezidencial "Zyber Hallulli" në Tiranë, duke përdorur burimet ekzistuese të insitituciionit për të ofruar shërbime alternative të përkujdesit. Praktikat e reja do të përfshijnë de-institucionalizimin, ri-organizimin e pjesshëm nga qendra rezidenciale në forma te kujdesit të tipit shtëpi- familje dhe komunitar.

Kujdestaria e Përkohshme " Hannah dhe Rozafa "

- ***Qëllimi i këtij projekti*** *është* të largojë përgjithmonë nga institucioni 10 fëmijë të moshës 0-1 vjec, të cilët do të jenë në kujdestari të përkohshme ne familje kujdestare.
- Identifikimi, trajnimi i familjeve kujdestare
- Deinstitucionalizimi do të ndodhë përmes bashkimit familjar dhe birësimit